

**UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”**

**FAKULTETI JURIDIK**

**STUDIMET POSTDIPLOMIKE – MASTER**

**DREJTIMI KONTRATA DHE E DREJTA KOMERCIALE**



**PUNIM MASTERI**

**PËRSËRITJA E PROCEDURËS KONTESTIMORE**

**Mentor:**

**Prof.Dr Rrustem Qehaja**

**Kandidatja:**

**Arbenita Rrahmani**

Prishtinë, 2024

## ABSTRAKT

Përsëritja e procedurës kontestimore është mjet i jashtëzakonshëm i goditjes, i cili iu jep mundësi palëve në procedurë të ankimojnë aktgjykimin në rastet kur pretendojnë së gjykata e shkallës së parë nuk ka dhënë aktgjykim meritore apo kur për çështjen marrin njohuri për fakte dhe prova të reja, të cilat në rast se do të diheshin më herët nga gjykata, do të merrej një aktgjykim më në favor të tyre. Iniciativa e palës është e domosdoshme, jo vetëm për fillimin e procedurës kontestimore dhe vazhdimin e saj, por edhe në rastin e përsëritjes. Studimi i këtij mjeti të jashtëzakonshëm, në përgjithësi na ndimon të kuptojmë më shumë vëllimin, strukturën, dinamikën dhe faktorët me ndikim në paraqitjen e kërkesës për përsëritje të procedurës. Përsëritja e procedurës kontestimore si mjet për goditjen e aktgjykimeve, është duke u zvogëluar në Kosovë. Andaj, qëllimi kryesor i këtij punimi është të njihemi më shumë për këtë procedurë së në çfarë rrethanash mund të kërkohet, çka mund të kërkohet përmes saj, me theks të veçantë në Komunën e Lipjanit, duke u bazuar në praktikën e Gjykatës Themelore në Prishtinë- dega në Lipjan për vitet 2016-2021. Në Gjykatën e Lipjanit, më saktësisht në arkivin e saj, janë mbledhur të dhëna për numrin e lëndëve civile që kanë paraqitur kërkesë për përsëritje të procedurës, karakteristikat dhe veçoritë e këtyre parashtruesve dhe shkaqet të cilat kanë ndikuar në paraqitjen e propozimit për përsëritje të procedurës për periudhën 2016-2021. Gjatë kësaj periudhe, në këtë gjykatë janë paraqitur gjithsej dy raste, të cilat janë refuzuar nga Gjykata e Apelit.

**Fjalët kyçe:** përsëritja e procedurës kontestimore, mjet i jashtëzakonshëm, gjykata.